



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

PÛRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR VJETOR TË PARTIVE POLITIKE
DHE MIRATIMIN E FORMATIT TË STANDARDIZUAR PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË PARTIVE
POLITIKE GJATË VITIT KALENDARIK, KONTROLLIN, VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE
SHPENZIMEVE TË TYRE, SI DHE MËNYRËN E PAGESËS SË AUDITUESVE LIGJORË

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 15/2, pika 2, shkronja “a”, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të hartuar dhe miratuar rregullat për raportimin financiar të partive politike, si dhe formatet e standardizuara për raportimin financiar vjetor.

Neni 23 i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, parashikon afatin e dorëzimit të raporteve financiare vjetore, personat përgjegjës për dorëzimin e këtyre raporteve si dhe afatin e publikimit të raporteve nga KQZ-ja. Nenet 23/1, 23/4 dhe 24, të ligjit të sipërpërmendur, përcaktojnë detyrimet që i linden partive politike në zbatim të këtij ligji.

Në zbatim të neneve 15/2, pika 2, shkronja “a”, 23, 23/1, 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, është hartuar projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë objektin dhe përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, mënyrën e raportimit sipas formatit të përcaktuar, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë.

Risite në këtë projektvendim:

- Formatit i standardizuar i raportimit financiar vjetor;
- raportimi online i formatit financiar vjetor, i cili hyn në fuqi nga raportimi i pasqyrave financiare vjetor për vitin 2023;
- formati i standardizuar i projektraportit të auditimit;
- raportimi online i formateve për projektraportin, si dhe për raportin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

Valbona BALLGJINI	- Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm
Madalena KOJA	- Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor
Aurel LAMÇE	- Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve
Ylli MERKAJ	- Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PÛRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR VJETOR TË PARTIVE POLITIKE,
MIRATIMIN E FORMATIT TË STANDARDIZUAR PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË PARTIVE POLITIKE
GJATË VITIT KALENDARIK, KONTROLLIN, VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË
TYRE, SI DHE MËNYRËN E PAGESËS SË AUDITUESVE LIGJORË

Në mbështetje të neneve 15/2, pika 2, shkronja “a”, 23, 23/1, 23/2, 23/3, 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar,

VENDOS:

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka për objekt:

- përcaktimin e rregullave për realizimin e procesit të raportit financiar vjetor të partive politike dhe detyrat e financierit apo personi përgjegjës sipas statutit të partisë politike;
- modelin e deklaratës së dhurimeve dhe regjistrin të dhurimeve;
- formatin e standardizuar për raportimin financiar për vitin kalendarik;
- mënyrën e pagesës së audituesve ligjor të përzgjedhur për auditimin e fondeve vjetore.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”

Neni 2

Raporti financiar vjetor i partisë politike

1. Partitë politike dorëzojnë raportin financiar vjetor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës në formë elektronike, në sistemin online dhe në një kopje fizike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Dorëzimi i raportit financiar vjetor bëhet nga financieri ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë politike, apo personi i pajisur me autorizim nga partia politike.
3. Raporti financiar vjetor duhet të jetë i firmosur nga Kryetari i partisë politike ose nga personi i autorizuar nga ky i fundit dhe financieri apo personi i përcaktuar sipas statutit të partisë politike.
4. Raporti financiar vjetor publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga koha e dorëzimit të tij prej partisë politike.

Neni 3

Raporti i auditimit

1. Audituesi ligjor i përzgjedhur nga KQZ-ja për të kontrolluar veprimtarinë financiare vjetore të partive politike, dorëzon raportin e auditimit në kopje fizike në KQZ dhe në format elektronik brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës së shërbimit me një shtyrje të argumentuar deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe jo më shumë se 2 (dy) herë.
2. Raporti i auditimit hartohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Audituesi ligjor i dorëzon partisë politike të audituar dhe KQZ-së projekt raportin, sipas shtojcës nr. 4, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura. Partia politike e audituar mund të bëjë me shkrim shpjegime në lidhje me përmbajtjen e projekt raportit dhe ja dorëzon audituesit ligjor brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja në dorëzim e tij.

4. Audituesi ligjor arsyeton dhe shqyrton shpjegimet (kundërshti/observacione) plotësuese dhe në rast të gjetjeve të shpjegimeve të arsyetuara ndryshon ose plotëson pjesët përkatëse të raportit të auditimit duke i pasqyruar ato në raportin përfundimtar.
5. Raporti përfundimtar i auditimit dorëzohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes në dorëzim të observacioneve, sipas shtojcës nr. 5.
6. Audituesi ligjor plotëson raportin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik në sistemin online dhe e dorëzon atë në KQZ, në format hard copy.
7. Raporti i auditimit publikohet në faqen e internetit të KQZ-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga depozitimi i tij në KQZ.

Neni 4

Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare vjetore të partive politike dhe krahasimet me raportet e auditimit

1. Administrata e KQZ-së verifikon dhe kontrollon respektimin e dispozitave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, dhe/ose aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës.
2. Administrata e KQZ-së, pas marrjes së raportit financiar vjetor nga partitë politike, bën verifikimin duke:
 - a) verifikuar elementët e formës juridike nëse janë sipas shtojcës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - b) kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
 - c) kontrolluar nëse janë deklaruar në raportin financiar vjetor fondet e përfituara dhe shpenzuara nga partia politike për qëllime jo zgjedhore.
3. Administrata e KQZ-së pas marrjes së raportit të auditimit bën verifikimin duke krahasuar të dhënat me gjetjet dhe konkluzionet e raportin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor), i përzgjedhur nga KQZ-ja për të audituar raportin financiar vjetor, si dhe

çdo informacion të marrë gjatë hetimit administrativ si rezultat i ankesave, kërkesave apo denoncimeve lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar.

4. Nëse nga krahasimi i raporteve financiare vjetore me raportin e auditimit rezulton se ka mospërpushmëri apo mangësi të raportit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve autorizon me shkrim kryerjen e verifikimeve të thelluara. Për qëllime të verifikimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron një riauditim nëpërmjet një audituesi të ri nga lista e audituesve ligjor. Audituesi i ri, për përgatitjen e raportit, ka të drejtë të:
 - a) intervistojë persona dhe subjekte të ndryshme;
 - b) marrë informacion nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c) këqyrë dokumente që lidhen me këto verifikime të thelluara pranë zyrave përkatëse të partisë politike;
 - d) marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë.
5. Audituesi i ri harton një raport përfundimtar dhe e dorëzon në KQZ brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
6. Pas përfundimit të procesit të riauditimit, administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit një relacion përfundimtar ku parashtrohet gjetjet nga verifikimi dhe kontrolli, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme. Komisioneri, brenda 48 (dyzet e tetë) orësh nga marrja e relacionit, miraton me shkrim gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura ose në rast se nuk bie dakord me to, bën refuzimin përkatës me shkrim duke arsyetuar refuzimin për të dhënë miratimin.

Neni 5

Financieri apo personi përgjegjës sipas statutit të partisë politike dhe përgjegjësitë

1. Të gjitha partitë politike të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të caktojnë një financier apo person përgjegjës sipas statutit të partisë politike.
2. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjektet që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilëve nuk është i përcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.

3. Partia politike ndërpret marrëdhëniet me financierin dhe emëron një financier të ri në rastet kur financieri:
- a) bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
 - b) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
 - c) jep dorëheqjen;
 - d) është në kushtet e konfliktit të interesave në raport me KQZ;
 - e) vdes.
4. Financieri i partisë politike apo personi përgjegjës sipas statutit të partisë politike mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij duke:
- a) administruar veprimtarinë vjetore të partisë politike;
 - b) regjistruar të gjitha transaksionet financiare, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë;
 - c) mbledhur dhe arkivuar/ruajtur të gjithë informacionin dhe dokumentet mbështetëse përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve. Regjistri i dhurimeve mbahet sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - d) dorëzuar raportin financiar vjetor duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;
 - e) siguruar që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga eksperti kontabël i licensuar apo KQZ-ja.
5. Personi përgjegjës për financat në partinë politike, brenda 3 (tre) muajve nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare të hapur për dhurimin e fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 (njëqind) mijë lekë. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 6

Mënyra e pagesës së audituesve ligjorë

1. Shpenzimet e nevojshme për auditimin e partive politike për vitin kalendarik mbulohen nga vetë partitë politike.
2. Partitë politike që përfitojnë fonde nga KQZ-ja dhe nuk shlyejnë detyrimin sipas pikës 1 të këtij neni, ky detyrim do t'u mbahet në momentin e shpërndarjes së fondeve vjetore të vitit pasardhës.
3. Partitë politike, të cilat nuk përfitojnë fonde nga KQZ-ja duhet të transferojnë fondet e nevojshme në llogarinë bankare të KQZ-së me qëllim pagesën e audituesve ligjorë. Afati për transferimin e këtyre fondeve duhet të jetë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dorëzimi i afatit përfundimtar të raportit të auditimit vjetor në KQZ.

Neni 7

Sanksionet

Shkelja e dispozitave të këtij vendimi ndëshkohet sipas neneve 23/4 dhe 24, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar.

Neni 8

Shfuqizim

Udhëzimi nr. 10, datë 21.04.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve", si dhe vendimi nr. 3, datë 18.01.2012, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e rregullave dhe formateve të standartizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël", shfuqizohen.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Format i ri i raportimit hyn në fuqi për vitin 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

1.2 Detyrimet gjatë vitit ushtrimor

Nr.	E M E R T I M I	Gjëndje në fillim të vitit ushtrimor	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Gjendja në mbyllje të vitit ushtrimor
1					
1	Te pagueshme				0
1.1	Të pagueshme për furnizime dhe shërbime				0
1.2	Të pagueshme për kontribute për punonjësit				0
1.3	Shteti/tatim taksa/tatim në burim	plotesim manualisht			#VALUE!
2	Dëftesa të pagueshme (ndaj te treteve)				0
3	Kontribute të marra në avancë				0
4	Paisje zyre, Informatike	plotesim manualisht			#VALUE!
5	Mjete transporti	plotesim manualisht			#VALUE!
6	Investime të tjera afat gjata	plotesim manualisht			#VALUE!
		plotesim manualisht			
		plotesim manualisht			
1	Grantet, Donacionet, Subvencionet	plotesim manualisht	0		#VALUE!
2	Kredi/Hua afatgjate		0		0

2. Informacion për partinë politike, përmbledhje financiare dhe deklarata

Pjesa A - Informacion për subjektin zgjedhor

Emri i plotë i partisë politike:

NIPT

Adresa e selisë së partisë politike

Emri/Mbiemri i personit përgjegjës për financat

Adresa e emailit e personit përgjegjës për financat

Numri i telefonit të personit përgjegjës për financat

Pjesa B - Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
a. Totali i të ardhurave nga fondet publike	ALL	-
b. Totali i të ardhurave jopublike monetare	ALL	-
c. Totali i të ardhurave jopublike ne natyre	ALL	-
d. Totali i të ardhurave nga degët e partisë	ALL	-
e. Totali i të ardhurave të krijuara nga vetë partia	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i shpenzimeve të bëra nga partia	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve të bëra nga degët e partisë	ALL	-
c. Totali i shpenzimeve indirekte/ Dhurimet ne natyre	ALL	-
d. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

Pjesa C - Deklarata

Duke qenë i/e vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme, në bazë të njohurive të mia më të mira dhe me përgjegjësi për përgatitjen e këtij raporti, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Firma e personit përgjegjës për financat/përgatitur nga:

Data e firmosjes:

Aprovuar/Miratur nga:

Data e firmosjes:

3.a Të ardhura - Financime publike

Shuma e fondeve publike të përfituara

- a. Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit (sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor nëse ka qenë vit zgjedhor)
- b. Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit
- c. Fondi i marrë nga buxheti i shtetit si ndihmë për vitin kalendarik (sipas nenit 19 të ligjit për partitë politike)
- d. Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:

Data e firmosjes:

Aprovuar/Miratuar nga:

Data e firmosjes:

3.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar
3.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

--

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

[illegible]

3.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar^{3.c}
Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

--

Firma e personit përgjegjës/ Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

A. Statusi i dhuruesit

B. Emri i dhuruesit

C. Mbiemri i dhuruesit

D. Adresa (rreshti 1)

E. Adresa (rreshti
2)

F. Kodi postar i
adreses

G. Numri i identifikimit

H. Vlera e dhurimit

I. Data e dhurimit

J. Totali i agreguar i
dhurimeve nga dhuruesi

K. Marrë në
dorëzim nga:

L. Emri i degës

S M. Përshkrimi i dhurimit
në natyrë

[illegible]

3.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike

Të dhënat e mëposhtme

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

- A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura
- B. Shuma e të ardhurave
- C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat
- D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat
- E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat
- F. Të ardhura të krijuara nga:
- G. Emri i degës (nëse është i aplikueshëm)
- H. Përshkrimi

Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit

Të ardhurat nga donacionet dhe kontributet vullnetar

Totali I të ardhurave jo publike për fushatën zgjedhore (si është raportuar tek formati I raportimit për fushatë)

Totali I të ardhurave nga kandidatët e listave shumëmbrore (si është raportuar tek formati I raportimit për fushatë)

Totali I të ardhurave nga kandidatët për kryetar bashkie (si është raportuar tek formati I raportimit për fushatë)

Të ardhura nga investimet apo dhurimet

Tarifat për shërbimet

Të ardhurat nga aktivitetet tregtare

Të tjera

4. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4. Huatë dhe Kreditë

Firma e personit përgjegjësPërgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Ministruar nga:	
Data e firmosjes:	

Termit											
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (neshë 1)	D. Adresa e huadhënësit (neshë 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kreditë	H. Shuma e huasë/limitit i kreditë	I. Data e fillimit të huasë/kreditë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolateral i ofruar

5. Shpenzimet e partisë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5. Shpenzimet e partisë

Të dhënat e mëposhtme

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

[illegible]

5.a Raportet sipas degëve

Ju lutem konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5.a Raportet sipas degëve

Firma e personit përgjegjës/përgatitës nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

A. Bashkia

B. Të ardhurat totale sipas secilës degë

C. Shpenzimet totale sipas secilës degë

-
- Belsh
- Berat
- Bulqizë
- Cërrik
- Delsinë
- Devoll
- Dibër
- Divjakë
- Dropull
- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Finiq
- Fushë Arrëz
- Gjirokastrë
- Gramsh
- Has
- Himarë
- Kamëz
- Kavajë
- Këlcyrë
- Klos
- Kolonjë
- Konispol
- Korçë
- Krujë
- Kuçovë
- Kukës
- Kurbini
- Lezhë
- Libohovë
- Libërcht
- Lushnjë
- Malësi e Madhe
- Maliq
- Mallakastrë
- Mat
- Memaliaj
- Mirditë
- Patos
- Peqin
- Përmet
- Pogradec
- Polican
- Prenjas
- Pukë
- Pustec
- Roskovec
- Rrogozhinë
- Sarandë
- Selenicë
- Shijak
- Shkodër
- Skrapar
- Tepelenë
- Tiranë
- Tropojë
- Ura Vajgurore
- Vau i Dejës
- Vlorë
- Vorë

[illegible]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË

DHURIMI PËR PARTINË POLITIKE

(Për vitin kalendarik)

Sot, më datë:

Unë deklарuesi:

Banues në:

D E K L A R O J:

Unë i nënshkruari _____ (emër, mbiemër), me cilësinë e personit fizik, juridik apo aksioner i tij _____, i dhuroj partisë politike _____, vlerë _____ (lekë) dhe deklарoj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të nenit 23/1, pika 1, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklарim të rremë.

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shtojca nr. 3

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

REGJISTRI I DHURIMEVE

(Për vitin kalendarik)

NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NË LEKË	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	NIPTI	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURIMI
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
SHUMA TOTALE E DHURUAR Shifër (fjalë) lekë						

Shënim: Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, partia politike do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, partitë politike do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Partia Politike _____, Financieri/personi përgjegjës sipas statutit të partisë politike _____
Emër, Mbiemër, Firmë



Miratuar me vendimin nr. __, datë __. __. 2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

PROJEKTRAPORT

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

- i. Kuadri ligjor
- ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

- i. Kontrata e shërbimit
- ii. Vendimi i KQZ-së
- iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

- i. Prezantimi i subjektit zgjedhor
- ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale): numri i anëtarëve, struktura dhe numri i degëve në qark dhe organizatat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me partinë (për shembull: fondacionet, organizatat e rinisë, etj.)

D. PREZANTIMI I RAPORTI DHE STRUKTURAT E TIJ

- i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.
- ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundshme midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.
- iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin vjetor të partisë politike: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.



Miraturar me Vendimin nr. __, datë __.__.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

II. KËRKESAT FORMALE**A. PËRMBLEDHJE**

1/ Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	Po/ Jo	Datë
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po/ Jo	Datë
	Identiteti i nënshkruesit	Po/ Jo	Emër

B. CAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE LLOGARISË BANKARE

1/ Informacioni për partinë politike		
	Emri i partisë politike	
	Adresa e selisë qendrore	
	Numri i telefonit të selisë qendrore	
	Adresa e email-it të selisë qendrore të partisë (nëse ka)	
2/ Informacion për audituesin ligjor		
	Emri i audituesit ligjor të caktuar	
	Adresa e audituesit ligjor	



Miraturar me Vendimin nr. __, datë __.__.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

	Numri i telefonit të audituesit ligjor	
	Adresa e email-it të audituesit ligjor (nëse ka)	
3/ Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike		
	Emri i bankës ku mbahet llogaria	
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	
	Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	
	Numri i llogarisë bankare	
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	

C. AKTIVET DHE DETYRIMET

1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve		
	Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit	
	Përshkruani vendndodhjen e aktivitet	
	Shkruani vlerën e tregut të aktivitet, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur	
2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve		
	Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit	
	Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet	
	Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve	



Miraturar me Vendimin nr. __, datë __.__.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare		
	Periudha e raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raporti)	
	Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raporti)	
	Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	
	Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	
	Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raporti)	
	Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	
	Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	

a/ Audituesi Ligjor

- **Identiteti i audituesit ligjor**
 - o Kush?
 - o Çështja e mospërputhjeve të mundëshme.
- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit vjetor.**
 - o Nënshkrimi i raportit vjetor
 - o Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: vërejtja e problemeve të dukshme (shiko më poshtë)

	a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)		



Miraturar me Vendimin nr. __, datë __.__.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

		Të Ardhurat		
			Financime publike	
			Donacione private	
			Financim nga burimet e veta të partisë	
			Hua/Kredi	
		Shpenzime		
			Shpenzimet e qerasë	
			Stafi / rrogat	
			Media	
			Komunikimi	
			Transporti	
			Shpenzimet bankare	
			Administrative dhe të Përgjithshme	
			Amortizimi	
			Menaxhimi i Pronës	
			Shpenzime të tjera	

b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarin e aktiveve dhe detyrimeve.
- Defiçit/ shpenzime të papaguara



